

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
" GRASSO COIN" SH.P.K.**

Në Tiranë, sot më datë 08.03 2018, u paraqitën personalisht ortaket themelues si më poshtë:

1. **Z. Damiano Giuseppe GRASSO**, shtetas austriak, i biri i Salvatore, lindur më 26.10.1987, në Innsbruck (AUT), dhebanues në Austri, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit/pasaportës Nr. YB1194502, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.
2. **Z. Fatos DANI**, shtetas shqiptar, i biri i Zenel, lindur më 12.09.1972, në Vlorë, dhe banues në Itali, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit Nr. Personal H20912081W dhe pasaportës Nr. BD5550137, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.
3. **Z. Salvatore GRASSO** shtetas italian, i biri i Giuseppe, lindur më 01.08.1958, në Ugento (LE), dhe banues në Austri, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit/pasaportës Nr. AU 6969759, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Të cilët hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë "**GRASSO COIN**" **SH.P.K.**, mbështetur në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ligjin 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si më poshtë:

**KREU 1**

**Neni 1**

**Krijimi**

Shoqëria "**GRASSO COIN**" **SH.P.K.**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "GRASSO COIN" SH.P.K., është një shoqëri, që themelohet ndërmjet ortakëve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

### Neni 3

#### Selia

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, në adresën Bulevardi "Bajram Curri", pallati NCE/298, kati i katërt, apartamenti nr.16, kodi postar 1004, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e tij, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

### Neni 4

#### Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është:

Aktivitete dhe shërbime të bazuara mbi kriptovalutën ( vlerat krypto; valutë elektronike) dhe mbi teknologjinë "Blockchain", këshillim, konsulencë dhe mbështetje për shit-blerje, tregëti në fushën e hardware, në fushën e minierave, menaxhim, marketing, ICO crowdfunding në zhvillimin dhe implementimin e software.

Prodhim dhe tregtim materiale ndertimi, inerte etj.

Tregtim me shumice e pakice te import eksport te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, hidrosanitare, hidraulike etj.

Tregtim me shumice e pakice te import eksport te makineri-pajisjeve industriale e bujqesore, pjeseve te kembimit te ndryshme etj.

Tregtim me shumice e pakice te import eksport te produkteve bujqesore e blegtorale, fruta-perime, bime medicinale e mjekesore.

Tregtimi i pjeseve te kembimit dhe aksesoreve per autovetura, kamione dhe motocikleta, Import, eksport, tregtim i automjeteve dhe riparim i tyre.

Veprimtari të ndërtimit në formën më të gjerë dhe në të gjitha fushta civile, industri tregtare, publike dhe private, me vendosjen në punim të impianteve elektrike, hidraulike, ndërtimi dhe riparimi i impianteve të sistemeve të ujërave të zeza, të ndërtimit të rrugëve, pastrimi i impianteve civile dhe industriale.

Ndërtim dhe mbarëvajtje, rikonstruksion të rrugëve, urave, autostradave, hekurudhave, mbikalimeve, punimeve detare, punimeve të pastrimit të lumenjve, të sistemeve hidraulike dhe të bonifikimit.

Veprimtari të transportit brenda dhe jashtë vendit me mjete të vetat dhe/ose me mjete të të tjerëve, për llogari të vetë shoqërisë dhe/apo për llogari të të tjerëve.

Aktiviteti i agjensisë së transporteve, krijimi dhe menazhimi i transportit të personave me autovetura dhe autobusa etj.

### Neni 5

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë "GRASSO COIN" SH.P.K. është e pakufizuar.

## KREU II KAPITALI

### Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000 lekë (një mijë lekë).

- a) Ortaku Damiano Giuseppe Grasso është zotërues i një kuotë me vlerë nominale 600 lekë, që përbën 60% të kapitalit themeltar.
- b) Ortaku Fatos Dani është zotërues i një kuote me vlerë nominale 250 lekë, që përbën 25% të kapitalit themeltar.
- c) Ortaku Salvatore Grasso është zotërues i një kuotë me vlerë nominale 150 lekë, që përbën 15% të kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtëparashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

### Neni 7

#### **Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

4. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të

ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- d) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.


Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9**

#### **Administrimi**

Shoqëria do të administrohet nga Z. Salvatore Grasso dhe Z. Fatos Dani sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 vjecare secili me të drejtë ripërtëritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.



Përveç kësaj, administratoret shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratoreve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Emërimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person jashtë ortakërisë.

#### Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyrat e tjerat e përcaktuara në ligjin dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve, bankat e të gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si përpara Bankave të të gjitha niveleve, për të kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, përpara Zyrave të Tatimit Taksave, Zyrave të Qeverisjes Vendore, Zyrave të Punës, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

#### Neni 11 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13  
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14  
Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nen për nen nga Ortakët e shoqërisë tregtare "GRASSO COIN" SH.P.K., nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "GRASSO COIN" SH.P.K.**

DAMIANO GIUSEPPE GRASSO

*Damiano Grasso*

FATOS DANI

*Fatos Dani*

SALVATORE GRASSO

*Salvatore Grasso*

*Përkthues*

*Fonida Brati*

*Fonida Brati*